



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
KRYETARI

Nr. 872/ prot.

Tiranë, më 12 . 9 .2024

Lënda: Kthim përgjigjeje

Drejtuar:

ZOTIT FATMIR XHAFAJ ✓
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR
KUVENDI I SHQIPËRISË

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.4, Tiranë

Për dijeni:

OPERACIONIT NDËRKOMBËTAR TË MONITORIMIT
Adresa: Rruga e Kavajës, ish-godina e “Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve”, Tiranë

I nderuar z. Xhafaj,

Përfitoj nga rasti t’ju shpreh juve dhe anëtarëve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, vlerësimin e gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit për veprimtarinë e këtij Komisioni në përmbushjen e qëllimit dhe objektivave të tij për avancimin e mëtejshëm të reformave modernizuese të shtetit, në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Në përgjigje të ftesës suaj për bashkëpunim dhe angazhim të përcjellë me anë të shkresës nr. 3019 prot., datë 31.07.2024, Mbledhja e Gjyqtarëve, pasi e diskutoi atë vlerëson se:

Kolegji i Posaçëm i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese, tashmë ka hyrë në fazën përmbyllëse të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i cili referuar parashikimeve përkatëse kushtetuese do të përfundojë në qershor të vitit 2026. Në këtë kuadër po punohet me intensitet të lartë dhe përkushtim maksimal nga të gjitha strukturat e Kolegjit për përfundimin e gjykimit të ankimeve lidhur me vendimmarrjet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, brenda mandatit kushtetues, përkrah ushtrimit të veprimtarisë edhe në funksion të juridiksionit disiplinor. Prej më shumë se katër vitesh, Kolegji funksionon me gjashtë nga shtatë gjyqtarët e tij, ndërkohë

që gjykimi i çështjeve të juridiksionit të rivlerësimit, të cilat përbëjnë volumn kryesor të çështjeve të regjistruara, bëhet nga trupa gjyquese të përbërë nga pesë gjyqtarë, duke sjellë si pasojë angazhimin e tyre në gjykimin e pothuajse të të gjitha çështjeve që i përkasin këtij juridiksioni. Në këtë situatë vlerësohet objektivisht e pamundur përfshirja e dy gjyqtarëve si pjesë e nëngrupit të ekspertëve të drejtësisë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar. Duke qenë se veprimtaria e gjyqtarëve të Kolegjit është e lidhur ngushtësisht me veprimtarinë e këshilltarëve ligjorë vlerësohet se edhe angazhimi i tyre pranë Komisionit do të ndikonte drejtëpërdrejtë në veprimtarinë e Kolegjit.

Ndodhur në këto kushte, me qëllim mos rrezikimin e përmbushjes në afat të këtij procesi të rëndësishëm, pjesë thelbësore e reformës në sistemin e drejtësisë, Kolegji vlerëson se bashkëpunimin me Komisionin e Posaçëm Parlamentar mund ta realizojë vetëm nëpërmjet një bashkëpunimi të vazhdueshëm institucional përgjatë realizimit të objektivave të Komisionit të Posaçëm Parlamentar, nëpërmjet dhënies së mendimeve/opinioneve apo propozimeve konkrete lidhur me dokumentet e projekt-aktet e nëngrupit të ekspertëve të drejtësisë, në të gjitha fazat e veprimtarisë së tij. Në çdo rast çmohet se për shkak të natyrës së posaçme, të jashtëzakonshme dhe me shtrirje të kufizuar në kohë të procesit të rivlerësimit kalimtar, kontributi i Kolegjit mbetet i kufizuar.

Përfitojmë nga rasti të sjellim në vëmendje të Komisionit se nga ana e Kolegjit në Kuvendin e Shqipërisë janë depozituar kërkesa për nisma ligjore lidhur me adresimin e disa çështjeve që prekin gjyqtarët dhe personelin e Kolegjit. Lidhur me këto çështje Kolegji mbetet në pritje të ndërmarrjes së këtyre nismave ligjore si dhe trajtimit të tyre, sipas procedurave parlamentare nga komisionet e përhershme të Kuvendit të Shqipërisë. Në rast se çështjet e trajtuara në këto kërkesa do të shqyrtohen edhe nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar, sugjerojmë që, nëse çmohet e nevojshme, ato të vlerësohen e përfshihen në Dokumentin Analitik, Planin Kombëtar të Veprimit, si dhe në nismat ligjore që do të ndërmarrë Komisioni.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Me respekt,

KRYETARI

SOKOL ÇOMO

